



KUSHTET DHE TERMET E PËRGJITHSHME TË LICENCËS SË KPM-SË

Pjesa e parë:

Përkufizime:

1. **KPM-ja:** Me Komision të Pavarur për Media (KPM) kuptojmë institucionin e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me Ligjin Nr. 04/L- 44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejshëm Ligji i KPM-së).
2. **Rregulloret e KPM-së:** Me Rregullore të KPM-së kuptojmë të gjitha aktet nënligjore mbi të drejtat dhe obligimet e të licencuarve në Republikën e Kosovës të miratuara nga Komisioni i Pavarur për Media që lidhen me transmetime radio-televizive dhe me rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele.
3. **Licencë:** Është leje kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për transmetime radio-televizive dhe shërbime mediale audiovizuale. Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së si dhe kushtet dhe termet e përgjithshme të Licencës së KPM-së.
4. **I Licencuar:** Nënkupton subjektin të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën dhe të drejtën e shfrytëzimit të frekuencës (ave), të drejtën për të ofruar shërbime programore dhe ritransmetim të programeve radio-televizive përmes operatorëve të rrjetit.
5. **Shërbim Medial Audio-vizuel:** Nënkupton shërbimin i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
6. **Program:** Nënkupton një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosur nga ofruesi i shërbimit medial forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
7. **Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës:** Nënkuptojmë të drejtat dhe detyrimet e të Licencuarit të zbatueshme për të gjitha shërbimet mediale audio-vizuele.
8. **Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës:** Nënkuptojmë parametrat e punës të një shërbimi medial audio-vizuel të vetëm që përfshijnë standardet minimale teknike, frekuencën,

vendndodhjen e sistemit të transmetimit, nivelin e lejuar të fuqisë, karakteristikat dhe lartësinë e antenës dhe informacione të tjera teknike të specifikuara në Tabelën Teknike që i është dhënë të licencuarit nga KPM-ja si pjesë përbërëse e licencës së tij.

9. **Formati i Programit të Licencuar:** Nënkuptojmë përbërësit e programit të shërbimit medial audio-vizuel siç specifikohet në Pjesën 3 të Licencës, duke përfshirë edhe standardet minimale programore.
10. **Harta e Zonës së Mbulimit:** Nënkuptojmë një hartë digjitale topografike të prodhuar nga KPM-ja, që përshkruan zonën e mbulimit të cilën i Licencuari është i autorizuar për ta mbuluar me sinjal radio apo TV.

2. Dhënia e Licencës:

Kohëzgjatja e Licencës: Me Ligjin për KPM, në bazë të nenit 21.2 përcaktohet që licenca e transmetimit për shërbime mediale audio-vizuele do të jetë e vlefshme shtatë (7) vjet për radio dhe dhjetë (10) vjet për TV. Mirëpo, duke marr parasyshë afatin e përcaktuar nga ITU për kalimin e Kosovës në sistemin e transmetimit digjital, në qershor 2015, kohëzgjatja e kësaj Licence mund të ndryshohet konform këtij afati, me anë të Ligjit për Digjitalizim.

3. Pajtueshmëria:

1. **Natyra e Licencës:** Pranimi i kësaj Licence përbënë një leje kontraktuale për të Licencuarin në bazë të së cilës obligohet që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së, aktet nënligjore të KPM-së dhe legjislacionin relevant të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.
2. **Vlefshmëria e Licencës:** Kjo licencë vlen kur veprohet në përputhje me kushtet dhe termet e saj si dhe me dokumentet ligjore të përcaktuara në paragrafin 3.1.
3. **Pajtueshmëria me urdhërat:** I Licencuari duhet të veprojë menjëherë në pajtueshmëri me të gjitha urdhërat dhe udhëzimet e dhëna nga KPM-ja për të vënë në zbatim Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore.
4. **Njoftime me interes publik:** I Licencuari duhet të transmetojë pa kompensim njoftimet që konsiderohen të nevojshme dhe urgjente për shëndetin, rendin dhe sigurinë publike të cilat mund të bëhen nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës.
5. **Monitorimi tek të licencuarit:** I Licencuari duhet të lejojë personelin e KPM-së të hyjë në ndërtesat dhe lokacione të tjera të cilat i shfrytëzon për transmetim, prodhim programesh ose si zyre, me qëllim të monitorimit ose kontrollimit të të gjitha regjistrimeve dhe paisjeve, të testojë të gjitha pajisjet, për të verifikuar pajtueshmërinë me legjislacionin e KPM-së.
6. **Fondet publike:** I Licencuari që merr fonde nga Buxheti i Republikës së Kosovës, apo fonde tjera publike që zbatohen në Republikën e Kosovës, obligohet që çdo vit të përgatisë një raport financiar publik për përdorimin e këtyre fondeve dhe ta dorëzojë atë edhe në KPM si pjesë të raportimit të rregullt vjetor të përcaktuar me Ligjin për KPM.
7. **Respektimi i Kodit të Sjelljes:** I Licencuari mban përgjegjësi për të vepruar në përputhje me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele, për të

gjitha programeve që i transmeton, pavarësisht nga burimi original i një programi të tillë.

8. **Mundësia për përgjigje:** Kur KPM konstaton shkeljen e Licencës, Ligjit dhe akteve nënligjore u mundëson të licencuarve të drejtën për tu përgjigjur për shkeljet e konstatuara.
9. **Kësaj Licence i bashkangjiten dokumentet ligjore të mëposhtme:**
 - 9.1. Ligji i KPM-së
 - 9.2. Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audiovizuale dhe dokumentet ligjore që lidhen me të e që janë nxjerrë nga KPM-ja;
 - 9.3. Pjesët 1, 2, 3 dhe 4 të Licencës së KPM-së;
 - 9.4. Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audiovizuale;
 - 9.5. Rregullorja për Taksën për Licencë;
 - 9.6. Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve;
 - 9.7. Rregullorja për të Drejtën e Autorit;
 - 9.8. Rregullorja për Cilësitë për dhënjën e Licencës;
 - 9.9. Ligji për Zgjedhjet;
 - 9.10. Ligji për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e përafërta;
 - 9.11. Ligji për Komunikime Elektronike;
 - 9.12. Ligji për Digjitalizim;
 - 9.13. Strategjia për Digjitalizim.
10. Të gjitha aktet tjera nënligjore të shpallura nga KPM-ja do të jenë poashtu pjesë përbërëse e pakos së licencës.

4. Detyrimet për të Drejtën e Autorit:

1. Të Licencuarit i kërkohet të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta, si dhe ligjet tjera në zbatim në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, në veçanti të sigurojnë leje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjitha programeve komerciale. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimit publik, prodhimi i të cilit është më i vjetër se 50 vjet, nuk kërkohet një leje e tillë.
2. I Licencuari obligohet që t'i sigurojë KPM-së kopje të marrëveshjeve për këto të drejta brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim.

5. Mbajtja e Arkivës:

1. I Licencuari duhet të mbajë arkivë për 21 ditë të të gjitha programeve të transmetuara.
2. I Licencuari me kërkesë të KPM-së, duhet të ofrojë arkivën brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim.
3. Arkiva e kërkuar duhet të ofrohet vetëm në formatin dhe formën e përcaktuar nga KPM-ja.

6. Informacionet e të Licencuarve që obligohen t'i ofrojnë KPM-së:

1. I Licencuari obligohet që brenda pesë (5) ditëve të punës të informojë KPM-në për ndryshimet në të dhënat e mëposhtme. Të gjitha këto do të trajtohen nga KPM-ja si të dhëna të hapura për publikun:
 - 1.1. Për çdo ndryshim në gjendjen e individëve, zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që kanë Licencë të KPM-së, ose pronësi të një pjese të saj, që mund të qojë në diskualifikimin e tyre për marrjen e licencës KPM duhet të njoftohet brenda pesë (5) ditëve të punës nga ndryshimi i gjendjes. Individu i diskualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur u bë për diskualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çregullimit të operimit të emetuesit. Te plotësohet nga rregullorja për kualifikim;
 - 1.2. Të dhënat e adresës së të licencuarit, telefoni, faksi ose informacione të tjera kontakti;
 - 1.3. Të dhënat teknik siç kërkohet në Pjesën II të Licencës së KPM-së;
 - 1.4. Menaxhmentin Kryesor (Zyrtarët e lartë), përfshirë drejtorin e subjektit, drejtorin e lajmeve dhe drejtorin teknik;
 - 1.5. Identiteti i pronarëve të rradhitur në kërkesën për licencë që zotërojnë më shumë se 10% të aksioneve të një shërbimi medial audiovizual, që është regjistruar si shoqëri aksionere;
 - 1.6. Identiteti i drejtorëve të OJQ-së që themelon një i Licencuar;
 - 1.7. Ndryshime të mëdha në orët e operimit;
 - 1.8. Ndërprerje të transmetimit më të mëdha se programi i planifikuar i një (1) dite të plotë.

7. Fillimi i Transmetimit:

I Licencuari duhet të fillojë veprimtarinë me shërbime mediale audio-vizuele dhe të veprojë në pajtueshmëri të plotë me kushtet dhe termet e licencës brenda 90 ditëve nga marrja e licencës ose një amendamenti të saj, përveç rasteve kur nga KPM-ja përjashtohet ky detyrim. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë afat, mund të rezultojë me rishikimin apo edhe anulimin e licencës.

8. Koha e transmetimit:

Përdorimi i një frekuence të licencuar lejohet 24 orë në ditë, shtatë (7) ditë në javë, përveç rasteve kur kufizohet me Kushtet dhe Termet Specifike të Licencës.

9. Përdorimi i Shërbimeve të Transmetimit:

I Licencuari mund të kontrakttojë një organizatë shërbimesh teknike, të aprovuar nga KPM-ja, me qëllim që të vëjë në funksion dhe të mirëmbajë transmetuesit dhe lidhjet në emër të të Licencuarit. Në këto raste, i Licencuari duhet të ruajë plotësisht të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me anë të Licencës.

10. Identifikimi i Subjetit:

1. I Licencuari që vepron si radio stacion, duhet ta identifikojë veten në mënyrë akustike, të qartë dhe në vazhdimësi me anë të emrit të tij të autorizuar së paku një herë në çdo 60 minuta, gjatë kohës së transmetimit.
2. I Licencuari që vepron si stacion televiziv duhet ta identifikojë veten nëpërmjet një shenje të veçantë identifikimi në ekran gjatë gjithë programit, me përjashtim të reklamave komerciale.
3. I Licencuari që ritransmeton programe të prodhuara nga organizata të tjera transmetuese duhet të identifikojë qartë dhe në vazhdimësi burimin e programit të ritransmetuar.

11. Praktikë e mbrojtjes së shëndetit:

1. I Licencuari duhet t'i vë në funksion të gjitha masat mbrojtëse në sistemet dhe objektet e transmetimit përse i përket mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe të publikut në përgjithësi, në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.
2. Strukturat e antenave duhet të jenë konform standardeve të përgjithshme Evropiane, të pranura për sigurinë e konstruksionit dhe të mirëmbajtjes, përfshirë përdorimin e dritave që duhen për sinjalizimin e mjeteve fluturuese, në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

12. Ndërprerjet e Transmetimit:

Ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të transmetimit nga i Licencuari, do të shërbejnë si bazë që KPM-ja të rishikojë rrethanat që mund të qojnë deri në anulimin e Licencës.

13. Pagesa për Licencë:

I Licencuari duhet të paguajë taksën për licencë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-së për mënyrën dhe nivelin e taksës për Licencë, brenda afatit të përcaktuar.

14. Format i Programit:

1. I Licencuari duhet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t'i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë mund të rezultojë deri në anulimin e Licencës.
2. I Licencuari obligohet që paraprakisht ta njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin me kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me kërkesën e të licencuarit.

15. Përdorimi dhe Bartja e Licencës:

1. **Natyra e Licencës:** Licenca është një leje kontraktuale nga ana e KPM-së për të përdorur një ose më shumë frekuenca specifike transmetimi, siç përcaktohet në Standardet Teknike, Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të kësaj Licence. Licenca nuk nënkupton pronësinë mbi frekuencën që shfrytëzohet për transmetim nga i Licencuari.
2. **Bartja e Licencës:** I licencuari nuk mund të bartë licencën ose frekuenc-ën(at) pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së.
 - 2.1. Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së.
 - 2.2. Kjo kërkesë do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimit të udhëheqësisë së të licencuarit, që është regjistruar si OJQ, në përputhje me Rregulloren e KPM-së për Kriteret Kualifikuese për Marrjen e Licencës. Në rastin kur KPM lejon transferimin e Licencës, në asnjë rrethanë nuk do të paguhet e as të pranohet asnjë kompensim financiar për transferimin e kësaj licence.
3. **Kontrolli Efektiv i Frekuencës:** I Licencuari nuk do të transferojë kontrollin efektiv të një frekuence të licencuar tek një palë e tretë, plotësisht ose pjesërisht, pa autorizim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së. Në asnjë rrethanë nuk do të paguhet ose pranohet shpërblim financiar për transferimin e licencës, në rastin kur leja për transferimin është dhënë nga KPM-ja.
4. **Leje për transferimin:** KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë. KPM-ja në bazë të kompetencave të saj, mund të kërkojë që çdo ransferim i një licence tek një pronësi e re t'i nënshtrohet një shqyrtimi publik ose një shpalljeje publike për një frekuencë të lirë për të siguruar që një transferim i tillë i shërben plotësisht interesave publike.
5. **Vdekja ose paaftësia e të Licencuarit:** Në rast se i Licencuari vdes, ose vërtetohet paaftësia e tij shëndetësore me anë të vendimi gjyqësor apo përmes një dokumenti shëndetësor, ose i Licencuari si organizatë ndërpret veprimtarinë, shpërbëhet ose deklarohet i falimentuar nga një autoritet kompetent, KPM-ja mund ta përfundojë Licencën ose t'ia transferojë Licencën një pasardhësi të kualifikuar.
6. Licenca nuk mund të llogaritet si kapital themelor apo pronësi dhe si e tillë nuk mund të jetë objekt i një likuidimi financiar ose trashëgimie.

16. Ndryshimet e Licencës:

1. **Kërkesa për të ndryshuar licencën:** Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.
2. **Aprovimi për ndryshimet e licencës:** Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet

dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor.

17. Sanksionet për Mosrespektimin e Licencës dhe Rregulloreve të KPM-së:

Sanksionet e zbatueshme: Për shkelje të kushteve dhe termeve të Licencës zbatohen sanksionet e parapara në Ligjin e KPM-së.

18. Pezullimi ose Anulimi i Licencës:

Pezullimi ose anulimi i licencës bëhet në bazë të Ligjit të KPM-së.

19. Forca Madhore:

1. **Marrja në konsideratë e Forcës madhore:** Në vlerësimin e neglizhimit të të Licencuarit për të vepruar sipas kushteve dhe termeve të Licencës së tij, KPM-ja do të merr parasysh të gjitha rrethanat e rënda dhe të pakontrollueshme të shkaktuara nga një *forcë madhore*.
2. **Mos-zbatimi i taksës për licencë:** *Forca Madhore* nuk do të jetë bazë për të justifikuar pezullimin e pagesës së taksës për licencë.

20. Gjuha: Në rast konflikti, përsa i përket interpretimit të kësaj Licence, versioni në gjuhën shqipe do të jetë dominues.

Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termet e përcaktuara në Pakon e Licencës së KPM-së.

EMRI: _____

DATA: _____

NËNSHKRIMI: _____

Për të Licencuarin: _____

Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, kjo licencë do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.

EMRI: _____

DATA: _____

Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave

NËNSHKRIMI:

VULA